



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE PARAUNIVERSITARE

Rruga: "Durrësit", Nr. 23, AL- 1001, Tiranë – SHQIPËRI

www.mash.gov.al

Tel: 00 355 4 225 987; Fax: 00 355 4 225678

Nr. 4414/4 Prot
Dh. 24.07. 2009

ARSIMI PROFESIONAL

PROGRAMI I LËNDËS

“QYTETARIA” PËR KLASËN E 10

MIRATOI

MINISTRI

FATOS BEJA

TIRANË, 2009



ministra e arsimit dhe shkencës
ministra e së nesërmes


INSTITUTI I KURRIKULËS DHE TRAJNIMIT

ARSIMI PROFESIONAL

PROGRAMI I LËNDËS: QYTETARIA

KLASA X

TIRANË, DHJETOR 2008

A handwritten signature in black ink, consisting of a large, stylized initial 'G' followed by a series of loops and a long horizontal stroke.

Në këtë program, qytetaria, përmbledh në vetvete një tërësi konceptesh ose vlerash themelore që janë të përbashkëta për të gjithë demokracitë moderne. Të kuptuarit e këtyre koncepteve dhe vlerave dhe i marrëdhënieve të tyre në kushtet e ndryshimeve të shpejta, si dhe i rreziqeve që bartin, është kushti paraprak për një pjesëmarrje të efektshme dhe të përgjegjshme të qytetarëve në procesin e rindërtimit demokratik.

Disa nga këto koncepte bazë të qytetarisë janë *të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, demokracia* (institucionet dhe procedurat; përfaqësimi dhe demokracia pjesëmarrëse; liritë demokratike) dhe *parimet demokratike* (përparësia e ligjit dhe e së drejtës, drejtësia shoqërore; barazia, pluralizmi; kohezioni shoqëror; përfshirja; mbrojtja e minoriteteve, solidariteti; paqja, stabiliteti dhe siguria etj.); *qytetaria* (fuqizimi dhe përgjegjësia; pjesëmarrja aktive etj.), zhvillimi (zhvillimi dhe ndryshimi i qëndrueshëm etj.).

Qytetari i përgjegjshëm dhe i vetëdijshëm për fatet e bashkësisë ku jeton dhe më gjerë, është i pajisur jo vetëm me njohuritë dhe konceptet e domosdoshme për të ndikuar në mirëqenien e vetes dhe të bashkësisë, por edhe me aftësitë intelektuale dhe pjesëmarrëse që e rrisin cilësinë e rolit të tij në bashkësi.

Në misionin historik të lëndës së qytetarisë bën pjesë zhvillimi i aftësive të tilla, si:

- aftësitë e të menduarit kritik,
- aftësitë e të qenit krijues dhe i efektshëm,
- aftësitë për të zgjidhur problemet,
- aftësitë për të zbatuar njohuritë,
- aftësitë për arsyetime dhe reflektime morale.

Në misionin e kësaj lënde bën pjesë edhe zhvillimi i aftësive që lidhen me sjelljen shoqërore, si:

- aftësitë pjesëmarrëse,
- aftësitë komunikuese,
- aftësitë për të bashkëpunuar,
- për të debatuar, për të negociuar dhe për të bërë kompromise,
- aftësitë ndërkulturore,
- aftësitë për të parandaluar dhe zgjidhur konfliktet,
- aftësitë për të shpallur të drejtat vetjake pa shkelur të drejtat e të tjerëve,
- aftësitë për të marrë përsipër përgjegjësi demokratike etj.,

Përveç të kuptuarit të koncepteve dhe të vlerave themelore dhe fitimit të aftësive themelore për një pjesëmarrje aktive dhe të përgjegjshme, në misionin e qytetarisë është edhe edukimi dhe konsolidimi i përkushtimit ndaj vlerave të njohura e të pranura si universale në shoqëri, si:

- bindja në rëndësinë e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë personale;
- bindja për vlerën dhe domosdoshmërinë e parimeve, institucioneve dhe procedurave demokratike, si dhe për rëndësinë e veprimit qytetar;
- përkushtimi ndaj shtetit të së drejtës, drejtësisë, barazisë dhe paanësisë;
- përkushtimi ndaj paqes dhe zgjidhjes pjesëmarrëse, paqësore dhe konstruktive të problemeve shoqërore;



- respektimi i kulturave të tjera dhe i ndihmesës së tyre për njerëzimin; pranimi i parimit të pluralizmit në jetën e përditshme;
- përkushtimi ndaj vlerës së mirëkuptimit të ndërsjellë, të bashkëpunimit, të mirëbesimit dhe të solidaritetit, si dhe ndaj luftës kundër racizmit, paragjykimeve dhe çdo forme të diskriminimit;
- përkushtimi ndaj parimit të zhvillimit njerëzor të qëndrueshëm, që mban parasysh ekuilibrin ndërmjet zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe mjedisor.

1. SYNIMI I LËNDËS

Lënda e qytetarisë synon:

- t'u japë nxënësve njohuritë dhe t'u zhvillojë aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe në mënyrat e zbatimit të tyre.
- të zhvillojë aftësitë e pjesëmarrjes së përgjegjshme qytetare të nxënësve dhe të rrisë përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen demokratike të problemeve të komunitetit.
- të zhvillojë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave, parimeve demokratike dhe rregullave e ligjeve të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi, të gjithë nxënësit:

- të pajisen me njohuritë e domosdoshme praktike për ligjin dhe me aftësitë për t'i përdorur ato në jetën e përditshme;
- të rrisin nivelin e përvetësimit dhe të kuptimit të parimeve dhe vlerave, që qëndrojnë në themel të kushtetutës e të ligjeve që rregullojnë marrëdhëniet në të gjitha fushat e jetës dhe të veprimtarisë njerëzore.
- të rrisin nivelin e ndërgjegjësimit dhe të njohurive për çështjet dhe kundërshtitë e sotme lidhur me ligjin dhe zbatimin e në fushat kryesore të veprimtarisë njerëzore.
- të rrisin pjesëmarrjen aktive qytetare në fushën e respektimit të Kushtetutës dhe të të drejtave të njeriut.
- të rrisin ndjenjën e tolerancës, të paanshmërisë dhe të drejtësisë.
- të zhvillojnë vullnetin dhe aftësinë për të zgjidhur mosmarrëveshjet përmes rrugës (mekanizmave) zyrtare dhe, kur është e nevojshme, përmes rrugës (mekanizmave) jo zyrtare.
- të zhvillojnë më tej aftësitë bazë, si: të menduarit kritik dhe arsyetimi, komunikimi, vëzhgimi, zgjidhja e problemit etj.



3. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE

KLASA 10

36 javë x 2 orë = 72 orë

Linja 1 Ligji dhe ne

Përshkrimi i linjës Sot, në çdo hap të jetës së përditshme ne ndeshemi me ligjin. Ligji është rregullatori i tërë veprimtarisë njerëzore në të gjitha fushat. Ne duhet të jemi përgjegjës për zbatimin e ligjit. Në të njëjtën kohë, ne duhet të jemi përgjegjës edhe për cilësinë e ligjeve që rregullojnë jetën tonë.

Orë të sugjeruara 5 orë

Linja	Objektiva
Ligji dhe ne	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore, nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none">• të shpjegojë qëllimin e ligjit;• të diskutojë për funksionet dhe natyrën e ligjit në shoqëri;• të identifikojë dhe vlerësojë pasojat e veprimit apo mosveprimit të ligjit në shoqëri;• të argumentojë me shembuj nga jeta e përditshme domosdoshmërinë e ligjit për shoqërinë;• të identifikojë dhe diskutojë për vlerat që qëndrojnë në themel të ligjeve;• të shpjegojë domosdoshmërinë e llojeve të ndryshme të ligjit në shoqëri;• të demonstrojnë aftësinë të vlerësojnë vlerat në qëndrimin ndaj ligjeve të caktuara;• të identifikojë raste të shkeljeve të ndryshme ligjore dhe të diskutojë për pasojat e tyre për veten, familjen dhe mjedisin ku jeton;• të evidentojë dhe analizojë faktorët që ndikojnë në qëndrimin e tij/saj ndaj zbatimit të ligjit;• të demonstrojë qëndrimin e tij ndaj dhunimit apo shkeljes së normave a ligjeve që kanë pasojë negative për individin dhe grupin shoqëror në të cilin bën pjesë.

LINJA 2: Familja

Përshkrimi i linjës: Familja është qeliza bazë e shoqërisë që ofron dashuri, mbrojtje, edukim. Ajo është shkolla e parë e të nxënësit për jetën, për të bashkëjetuar me të tjerët.



Si e tillë ajo duhet të mbrohet për të kryer si duhet detyrat ndaj fëmijëve dhe shoqërisë
Orë të sugjeruara 6 orë

Linja	Objektiva
Familja	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë evolucionin historik të familjes; • të dallojë familjen si një qelizë e shoqërisë; • të tregojë që familja është pjesë e një bashkësie më të madhe, që është shoqëria; • të përshkruajë funksionet kryesore të familjes; • të dallojë lidhjet që ekzistojnë ndërmjet zhvillimit demografik dhe plakjes së popullsisë; • të tregojë ligjet që rregullojnë marrëdhëniet familjare; • të përshkruajë disa nga problemet e familjes së sotme; • të mbledhë fakte e të dhëna për problemet e familjes e të bëjë interpretimin e tyre; • të parashikojë pasoja të ndryshme tek funksionet e familjes të qëndrimeve, të politikave ose të ligjeve të ndryshme.

LINJA 3: Fëmijëria

Përshkrimi i linjës: Fëmijë quhen personat deri në moshën 18 vjeç. Ata kanë të drejta dhe detyra. Ata duhet të kenë mundësi të rriten në një mjedis të qetë e të sigurt, duhet të mbrohen nga shfrytëzimi dhe nga dhuna. Në të njëjtën kohë ata duhet të mësojnë të jenë të përgjegjshëm jo vetëm për vete por edhe për të tjerët dhe për bashkësinë ku jetojnë
Orë të sugjeruara 9 orë

Linja	Objektiva
Fëmijëria	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të japë përcaktimin ligjor të termit fëmijë. • Të flasë për të drejtat dhe detyrimet e fëmijëve sipas ligjeve në fuqi. • Të përshkruajë përgjegjësinë civile dhe penale të fëmijëve sipas ligjit shqiptar. • Të përshkruajë ligjet shqiptare që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe kujdesin për fëmijët. • Të tregojë, me shembuj, për mosrespektimin e të drejtave të fëmijëve. • Të rendisë disa nga problemet me të cilat përballen fëmijë të ndryshëm në bashkësinë ku jetojnë.



	<ul style="list-style-type: none"> • Të përmendë fakte që flasin për gjendjen e respektimit të të drejtave të fëmijëve në botë. • Të japë ide për përmirësimin e gjendjes së fëmijëve në bashkësinë ku jeton dhe më gjerë. • Të mbledhë fakte e të dhëna për problemet e fëmijëve e të bëjë interpretimin e tyre. • Të parashikojë pasoja të ndryshme të cilësia e fëmijërisë e qëndrimeve, politikave ose ligjeve të ndryshme. • Të marrë pjesë në veprimtari që ndikojnë në përmirësimin e gjendjes së fëmijëve në bashkësinë ku jeton.
--	--

LINJA 4: Puna

Përshkrimi i linjës: Puna është një e drejtë e sanksionuar në kushtetutë dhe e rregulluar me ligje të ndryshme. Ajo ndryshon në varësi të ndryshimeve ekonomike dhe shoqërore dhe është një ndër faktorët kryesorë të realizimit të çdo individi.

Si e tillë ajo duhet të jetë një mundësi për të gjithë dhe asnjëherë nuk duhet të jetë një faktor që krijon dhe mbështet diskriminime për arsye të ndryshme.

Orë të sugjeruara 12 orë

Linja	Objektiva
Puna	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të japë një përcaktim të termave punë dhe punoj. • Të rendisë lloje të ndryshme punësh. • Të dallojë faktorët kryesorë që mundësojnë një proces prodhues; • Të tregojë përgjegjësinë e shtetit për punën. • Të rendisë të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve sipas legjislacionit shqiptar për punën. • Të rendisë disa nga hapat e domosdoshëm për të kërkuar punë. • Të përshkruajë tablonë e disa prej ndryshimeve kryesore që ka pësuar bota e punës në shoqërinë shqiptare dhe pasojat e tyre për botën e punës në Shqipëri. • Të përshkruajë disa nga tiparet kryesore të botës së punës në Evropë dhe kërkesat që shtron ajo për të rinjtë shqiptarë që dëshirojnë të jetojnë në të. • Të diskutojë për disa nga dukuritë, me të cilat ndeshen emigrantët shqiptarë në botën e punës jashtë Shqipërisë. • Të mbledhë fakte e të dhëna për problemet e punës së fëmijëve e të bëjë interpretimin e tyre. • Të parashikojë pasoja në aspekte të ndryshme të jetës së fëmijës

	qëndrime ose praktika të caktuara që lidhen me punën e fëmijëve në familje ose në shoqëri
--	---

LINJA 5: Mjedisi

Përshkrimi i linjës: Mjedisi është burimi kryesor i jetës në Tokë dhe për këtë arsye duhet ruajtur dhe përdorur me kujdes. Mjedisi sot përdoret në mënyrë të pabarabartë në vende të ndryshme të botës dhe kërcënohet nga faktorë të shumtë. Mbrojtja e tij është një domosdoshmëri jo vetëm për brezat e sotëm, por edhe për brezat e ardhshëm.

Orë të sugjeruara 9 orë

Linja	Objektiva
Mjedisi	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegojë lidhjen ndërmjet ruajtjes së mjedisit dhe ruajtjes së vetë njeriut. • Të dallojë rreziqet me të cilat përballet sot planeti ynë. • Të rendisë disa prej angazhimeve ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit. • Të parashikojë pasojat që ka prishja e ekuilibrave ekologjikë për planetin dhe jetën e njeriut. • Të krahasojë mënyrën se si vende të ndryshme të botës i shfrytëzojnë burimet natyrore. • Të dallojë rolin e dyfishtë të shkencës dhe të teknologjisë në drejtim të mjedisit. • Të diskutojë për përgjegjësinë e secilit për mbrojtjen e mjedisit. • Të përshkruajë detyrimet ligjore të shtetit shqiptar për mbrojtjen e mjedisit. • Të bëjë kërkime të pavarura ose në grup për mënyrën se si trajtohet mjedisi në nivele të ndryshme të qeverisjes vendore ose qendrore. • Të përkufizojë me fjalët e tij termin zhvillim i qëndrueshëm. • Të shpjegojë rëndësinë e marrjes parasysh të pasojave të veprimeve dhe sjelljeve tona mjedisore për brezat e ardhshëm dhe për ardhmërinë në përgjithësi. • Të tregojë me shembuj që mbrojtja e mjedisit është përgjegjësi individuale. • Të bëjë kërkime të pavarura ose në grup për shkallën në të cilën mbahet parasysh e ardhmja në vendimmarrjet individuale dhe shoqërore. • Të parashikojë disa nga pasojat që kanë për brezat e ardhshëm,

	<p>zgjedhjet që bëjnë individët, grupet ose shteti.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajë me fjalët e tij/saj përmbajtjen e ligjeve kryesore për mbrojtjen e mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.
--	--

LINJA 6: Shëndeti

Përshkrimi i linjës: Shëndeti përbën një të drejtë dhe një vlerë që duhet mbrojtur me kujdes. Ai sot rrezikohet nga armiq të shumtë, të cilët mund të shmangen me informacion dhe masa parandaluese. Në të njëjtën kohë, ai është fushë e kërkimeve të shumta, që shoqërohen edhe me shumë pikëpyetje për njerëzimin.

Orë të sugjeruara 7 orë

Linja	Objektiva
Shëndeti	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të japë një përkufizim për shëndetin. • Të rendisë rreziqet kryesore që e kërcënojnë shëndetin. • Të flasë për disa prej sëmundjeve që lidhen me mirëqenien dhe problemet shoqërore. • Të shpjegojë pse shëndeti është një e drejtë dhe detyrë e çdo qytetari. • Të shpjegojë rëndësinë e informacionit dhe të parandalimit për mbrojtjen e shëndetit. • Të përshkruajë disa prej veprimtarive ose hapave që duhen ndjekur për ruajtjen e shëndetit në mjedise të ndryshme. • Të përshkruajë dëmet që shkaktojnë disa prej armiqve të shëndetit, si droga, alkooli, duhani etj. • Të argumentojë, bazuar në ligjin shqiptar dhe në njohuritë e marra nga lëndët e tjera, rëndësinë e luftës kundër këtyre armiqve të shëndetit. • Të listojë dhe të shprehë qëndrimin e tij për kundërshtitë që ekzistojnë lidhur me përdorimin e drogës, alkoolit, duhanit dhe për karakterin e tyre të ligjshëm ose jo. • Të përdorë ligjin për shëndetin për mbrojtjen e shëndetit të tij dhe të tjerëve në jetën e përditshme. • Të përdorë njohuritë e fituara për të mbrojtur shëndetin e tij nga rreziqet dhe disa prej sëmundjeve të njohura. • Të mbledhë fakte e të dhëna për problemet e shëndetit e të bëjë interpretimin e tyre. • Të parashikojë pasoja të sjelljeve dhe të qëndrimeve të ndryshme të shëndeti.

LINJA 7: Ushqimi

Përshkrimi i linjës: Ushqimi siguron energjinë bazë për funksionimin e organizmit njerëzor. Për të kryer si duhet detyrën për të cilën përdoret, ushqimi duhet të jetë cilësor dhe i kontrolluar. Çdo individ duhet të jetë i informuar për ushqimet që duhet të përdorë, që përdor dhe për ushqimet që janë të dëmshme për organizmin e tij

Orë të sugjeruara 6 orë

Linja	Objektiva
Ushqimi	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none">• Të përshkruajë çdo të thotë të ushqehesh.• Të përdorë, duke u mbështetur edhe në njohuritë e marra nga lëndët e tjera (biologji, kimi) konceptet kryesore fiziologjike që lidhen me të ushqyerit, për përshkrimin ose argumentimin e qëndrimeve të ndryshme qytetare.• Të rendisë disa nga ushqimet më të shëndetshme mbi bazën e kritereve shkencore.• Të shpjegojë rëndësinë e të ushqyerit në mënyrë të baraspeshuar.• Të përshkruajë disa nga sëmundjet që lidhen me qëndrimin ndaj të ushqyerit.• Të dallojë ushqimet e natyrore e të shëndetshme nga ato të ndryshuara.• Të shprehë qëndrimin e tij për çështje që kanë të bëjnë me prodhimin e ushqimeve të ndryshuara gjenetikisht.• Të përdorë ligjin shqiptar që mbron të drejtat e individit në fushën e ushqimit, për të mbrojtur veten dhe të tjerët nga ushqimet e ndryshuara.• Të mbledhë fakte e të dhëna për problemet e ushqimit e të bëjë interpretimin e tyre.

LINJA 8: Konsumatori

Përshkrimi i linjës: Çdo individ është një konsumator. Si i tillë ai është edhe objekt i abuzimeve të ndryshme, të cilat mund të shmangen nëse merret informacioni i duhur jo vetëm për produktet që konsumohen, por edhe për të drejtat dhe detyrimet që ai ka si konsumator ndaj shoqërisë.

Orë të sugjeruara 8 orë

Linja	Objektiva
-------	-----------



Konsumatori	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajë kërkesat kryesore të ligjit për konsumatorin. • Të përcaktojë përmbajtjen e konceptit konsumator dhe të përshkruajë të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit. • Të përshkruajë disa nga faktorët që ndikojnë në sjelljet e konsumatorit • Të demonstrojë aftësi për të zgjidhur probleme të thjeshta si konsumator. • Të analizojë dhe përshkruajë elementet kryesore të kontratës së shitblerjes. • Të shpjegojë elementet dhe rëndësinë e garancisë për respektimin e të drejtave dhe të detyrimeve të konsumatorit. • Të përshkruajë funksionet e reklamës dhe të analizojë raste të keqpërdorimit të saj si shkelje të interesave dhe të të drejtave të konsumatorit. • Të identifikojë organizata që punojnë e luftojnë për zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e konsumatorit. • Të diskutojë për rrugë dhe forma të ndryshme të mbrojtjes së konsumatorit dhe të ndër marrë veprime konkrete në mbrojtje të të drejtave të tij dhe të konsumatorëve të tjerë.
--------------------	--

LINJA 9: Siguria rrugore

Përshkrimi i linjës: Të gjithë jemi përdorues të rrugës. Në disa raste jemi shkelës të rregullave të qarkullimit dhe në disa raste të tjera viktime të shkeljeve të të tjerëve. Njohja dhe zbatimi i rregullave do të shmangte shumë pasoja të rrezikshme për jetën tonë dhe të të tjerëve.

Orë të sugjeruara 10 orë

Linja	Objektiva
Siguria rrugore	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dallojë sinjalet kryesore rrugore që rregullojnë qarkullimin e këmbësorëve, të biçikletave dhe të motoçikletave. • Të përcaktojë sjelljen e këmbësorëve, biçikletave dhe motoçikletave në rrugë në raport me përdoruesit e tjerë të rrugës. • Të marrë vendim për lëvizjen e tij në rrugë në përputhje me rregullat e qarkullimit rrugor. • Të gjykojë për rregullsinë ose parregullsinë e lëvizjes së përdoruesve të rrugës.



	<ul style="list-style-type: none"> Të vlerësojë dhe të parashikojë pasojat e moszbatimit të rregullave të qarkullimit rrugor për individët dhe shoqërinë etj.
--	--

4. KËRKESAT NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Qytetaria	Matematika
Familja, shkolla, adoleshenca, puna	Nxënës/i-ja: <ul style="list-style-type: none"> të llogaritë përqindjen në situata specifike, si: ndryshimet demografike, braktisja shkollore, shfrytëzimi i fëmijëve në botë. të lexojë të dhënat nga statistikat.
Qytetaria	Fizika
Mjedisi	Nxënës/i-ja: <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajë energjinë, burimet e energjisë dhe mënyrat e shfrytëzimit të tyre.
Qytetaria	Biologjia
Shëndeti	Nxënës/i-ja: <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajë rrugët dhe mënyrat e mbrojtjes së shëndetit, si: metodat kontraceptive, higjiena, drogat. të përshkruajë faktorët dhe pasojat e një ushqimi të shëndetshëm, dietat dhe sëmundjet që rrjedhin nga kequshqyerjet.
Qytetaria	Kimia
Mjedisi	Nxënës/i-ja: <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajë mbetjet energjetike dhe mënyrat e pastrimit të ndotjeve prej tyre.
Qytetaria	Psikologjia
Shëndeti, ushqimi	Nxënës/i-ja: <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajë llojet dhe shkaqet e disa sëmundjeve mendore, karakteristike të moshës dhe jetës së përditshme. të përshkruajë anoreksinë dhe buliminë, si dhe faktorët që ndikojnë në to.

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar. Ai është vetëm një pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e qytetarisë

Është mirë që përdoruesit e dokumenteve të përmendura të njohin të kenë njohuri edhe për standardet e fushave të tjera të të nxënit, si dhe për programet e lëndëve të tjera të të njëjtit vit.



Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, racore, fetare etj.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që t'i realizojnë ato. Realizimi i objektivave në kapituj ose në tema dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Për shembull, nëse programi i lëndës "Qytetaria" kërkon që nxënës/i,-ja të jetë i/e aftë "Të mbledhë fakte e të dhëna për problemet e ushqimit e të bëjë interpretimin e tyre", kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia të realizojnë këtë objektiv. Për realizimin e këtij objektiv nxënësit duhet t'i jepet detyra, koha dhe mundësi të tjera që të mbledhë fakte për çështjen në fjalë dhe të bëjë interpretimin e tyre.

Nëse një mësues/ese nuk e bën këtë, kjo do të thotë se ai/ajo nuk e ka zbatuar programin lëndor lidhur me këtë objektiv.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi duhet të ketë të qartë nivelet e arritjes së një objektiv nga nxënës/i,-ja si më poshtë:

1. Aftësia për të identifikuar dhe përshkruar (nivel i ulët intelektual).
2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar (nivel mesatar intelektual).
3. Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë intelektual).

Për shembull, programi kërkon që nxënës/i,-ja të jetë i/e aftë:

Të shprehë qëndrimin e tij për kundërshtitë që ekzistojnë lidhur me përdorimin e drogës, alkoolit, duhanit dhe për karakterin e tyre të ligjshëm ose jo.

Ky objektiv mund të arrihet në disa nivele:

- I. Nxënës/i,-ja dallon kundërshtitë në pikëpamje.
 - II. Nxënës/i,-ja shpjegon lidhjen ndërmjet një pikëpamjeje me pasojat që ka zbatimi i saj në praktikë.
 - III. Nxënës/i,-ja krijon qëndrimin e tij/saj për çështjen në diskutim, të mbështetur me argumente që mbajnë parasysh edhe argumentet e të tjerëve të ndryshme nga të vetat.
- Së pari, mësues/i,-ja duhet t'i krijojë çdo nxënës/i-eje mundësinë të shprehë arritjet e tij/saj në të gjitha nivelet. Kjo do të thotë se mësues/i,-ja nuk duhet të paragjykojë si përfundimtare aftësitë e një nxënës/i-eje që arrin nivelin e parë, por t'i japë atij/asaj, me anë të pyetjeve të tjera, mundësinë të shprehet edhe në nivelet e tjera.
 - Së dyti, mësues/i,-ja duhet të vlerësojë nxënësi/in-en për nivelin e shprehur të arritjeve, pasi t'i ketë dhënë atij/asaj të gjitha mundësitë të shprehë aftësitë e veta.

Orët mësimore



Programi i qytetarisë për klasën e 10 të arsimit profesional është strukturuar në linja që vijnë njera pas tjetrës, por nuk do të thotë se mësimdhënia-mësimnxënia duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduesc. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, por janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Domethënë, mësuesi/ja mund të vendosë të përparojë më ngadalë kur ve re se nxënësit e tij, hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të kapitullit, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit e tij/saj demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm të objektivave.

Në programin e lëndës së qytetarisë afërsisht **60-65%** e orëve mësimore gjithsej janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe **40-35%** e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive bazë të tij (konceptet themelore)
- Testimin e njohurive bazë.
- Integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës.
- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme).
- Përsëritjen vjetore (Pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë).
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- Aftësive të përgjithshme, si aftësia e komunikimit, aftësia e manaxhimit të informacionit, aftësia e zgjidhjeve problemore, aftësia e të menduarit kritik dhe krijues.
- Aftësive që lidhen me veçoritë e lëndës.
- Formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike, projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

6. VLERËSIMI



Vlerësimi i nxënës/it-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Mësuesi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i-ja vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera.

Në punimet e nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe kryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësuesi/ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi/ja vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësve. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet e shkurtër për një objektiv të veçantë të të nxënësve, deri tek ato një orësh; teste me alternativë ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Një mundësi vlerësimi dhe vetëvlerësimi është **portofoli i nxënës/it-es**, që është një përmbledhje e punimeve të tij/saj përgjatë një periudhe të caktuar kohe ose gjatë gjithë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësuesi rekomandon.

Në vlerësim, mësuesi duhet të marrë parasysh çrregullime të diagnostikuara si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të fëmijëve të ardhur rishtazi nga emigracioni etj. Ai duhet t'u krijojë mundësi këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar ato me shkrim ose me gojë.

Të veçanta

Standardet e përmbajtjes së lëndës së qytetarisë përfshijnë tri elemente të ndërlidhura me njëri-tjetrin: **njohuritë, aftësitë intelektuale e të pjesëmarrjes dhe prirjet qytetare.** Të marra së bashku këto elemente përbëjnë bazën për zhvillimin e



edukimit qytetar dhe për rrjedhojë edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve të pasqyrojë nevojën për të vlerësuar shkallën e përvetësimit të këtyre tri elementeve nga nxënësit.

Njohuritë përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen, për shembull, në pyetje të tilla, si:

- Cili është thelbi i qytetarisë dhe i jetës qytetare në demokraci?
- Cilat janë bazat mbi të cilat ngrihet sistemi demokratik në vend?
- Si dhe në çfarë shkalle sistemi politik në vend bazohet në qëllimet, vlerat dhe parimet e demokracisë të pranuarra gjerësisht nga shoqëria jonë?
- Cili është roli i qytetarit në demokraci? etj.

Aftësitë intelektuale e pjesëmarrëse të edukimit qytetar përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar me efektshmëri e në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e për të zgjidhur sfidat e jetës. Aftësitë intelektuale i aftësojnë nxënësit të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë qytetare në funksionet e shumta dhe të ndryshme të qytetarit. Këto aftësi i ndihmojnë ata të **identifikojnë, të përshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet, si dhe të vlerësojnë, të marrin dhe të mbrojnë qëndrime të caktuara për çështje të jetës publike.**

Aftësitë pjesëmarrëse i përgatisin qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë në jetën publike dhe qytetare, duke bashkëpunuar me të tjerët, duke formuluar dhe duke shprehur qartë idetë dhe interesat e tyre, duke bërë koalicione, duke kërkuar mirëkuptim, duke bërë marrëveshje dhe duke manaxhuar konfliktet.

Një rol të rëndësishëm në lëndën e edukimit qytetar ka edhe vlerësimi, në atë shkallë që është e mundshme, i aftësive pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se testimi duhet të përfshijë edhe *matjen e shkallës, në të cilën nxënësit kuptojnë përdorimin e duhur të aftësive pjesëmarrëse.* Këtu duhet të sqarojmë se në këtë vlerësim nuk përfshihet matja e drejtpërdrejtë e aftësive pjesëmarrëse të nxënësve, për shembull, në qeverinë e nxënësve në shkollë ose në veprimtari të tjera publike.

Elementi i tretë janë *prirjet qytetare* që përshkojnë të gjitha aspektet e qytetarisë. Në një sistem demokratik ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe me përgjegjësitë e individëve në shoqëri dhe me çuarjen përpara të idealeve të qeverisjes demokratike.

Këtu përfshihen prirjet:

- për të qenë një anëtar i pavarur i shoqërisë,
- për të respektuar vlerat vetjake dhe dinjitetin njerëzor,
- për të marrë përsipër përgjegjësitë vetjake, politike dhe ekonomike të qytetarit,
- për t'iu bindur "rregullave të lojës", si: pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimit të të drejtave të pakicave,
- për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirinformuar, të arsyeshme dhe të efektshme,
- për të nxitur dhe për të mbështetur funksionimin e shëndetshëm të demokracisë në vend.



Vlerësimi i prirjeve qytetare të nxënësve të përqendrohet në pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e rëndësisë që kanë këto prirje për demokracinë. **Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet vetjake të nxënësve të vlerësuar.**

Për këtë arsye, pyetjet që lidhen me prirjet qytetare **të lidhen me njohuritë dhe aftësitë intelektuale.** Për shembull, nxënësit mund t'i kërkohej të përshkruajë rëndësinë e dëgjimit me respekt të mendimeve dhe opinionëve të tjerëve. Po kështu, nxënësve mund t'u vlerësohet, për shembull, aftësia për të vëzhguar dhe për të zbuluar shkallën e përputhjes së veprimtarisë së qeveritarëve ose të institucioneve qeverisëse me parimet kushtetuese.

Fitimi i njohurive, i aftësive dhe zhvillimi i prirjeve qytetare realizohen në kushte të ndryshme, si: shtëpi, shkollë, bashkësi etj. Të gjitha këto përbëjnë edhe fushat kryesore, në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë, por edhe zbatohen ato në praktikë. Për këtë arsye, një mundësi e mirë për të vlerësuar aftësitë intelektuale, në procesin e zbatimit të njohurive dhe të pjesëmarrjes qytetare, janë projektet qytetare, që përfundojnë me një produkt të caktuar, për shembull, me një portofol individual, grupi ose klase.

